

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN UDËNISHT POGRADEDEC

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Udënisht, Pogradec**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri më 30.9.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 35, datë 15.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 225/11, datë 17.4.2014, i ka rekomanduar z. Durim Toska, Kryetar i Komunës Udënisht, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Komuna Udënisht, të merren masa për tu bërë vetëvlerësimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve, duke paraqitur: mjedisin e kontrollit; aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin. Në mjedisin e kontrollit të përcaktohen faktorët, si integriteti, vlerat etike, si dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë, filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi.

Menjëherë

2. Nga Komuna Udënisht, të merren masa për hartimin e miratimin e akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm.

Vazhdimisht

3. Nga Komuna Udënisht, të merren masa për të kryer regjistrimin e çeljes së fondeve nga të ardhurat sipas kriterëve të përcaktuara në kapitullin “V” klasa 7 të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Menjëherë

4. Nga Komuna Udënisht, të merren masa duke u ngritur Grupi për Strategji Buxhet dhe Integrim, (GSBI) i kryesuar nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, grup i cili të jetë përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) brenda njësive përkatëse, si dhe të ngrihen Ekipet e Menaxhimit të Programit (EMP), në përmbushje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor” si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006.

Vazhdimisht

5. Nga Komuna Udënisht të merren masa që vendimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, i gjithë dokumentacioni shoqërues dhe detyrimet financiare, në të ardhmen të jepen duke zbatuar me korrektësi ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

Vazhdimisht

6. Nga Komuna Udënisht të merren masa të menjëhershme dhe të bëhen rregullimet përkatëse në rregulloren e Organizimit e Funksionimit, lidhur me vendosjen e detyrimit dhe përshkrimin e vendeve të punës për vënien nën administrim, inventarizimin dhe vënien në efikasitet të aseteve, resurseve në administrim, pronësi, përdorim dhe juridiksion të sajë, në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 08.7.2010 “Për menaxhimin Financiarë”.

Menjëherë

7. Nga Komuna Udënisht të merren masa për zbatimin sa më të plotë e korrekt të kriterëve ligjore të përcaktuara nga ligji “*Për prokurimin publik*” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, me qëllimin

zbatimin dhe realizimin e prokurimeve publike në përputhje me kriteret ligjore. Titullari i AK, për çdo procedurë prokurimi duhet të ngejë Komisionin për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe bazuar në procesverbalin e KLLFLST, të miratojë fondin limit dhe specifikimet teknike.

Vazhdimisht

8. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast të shqyrtohen dhe të paraqiten për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi të cilat janë të shoqëruara me dokumentin e pronësisë (vërtetim pronësie ose certifikatë pronësie e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme) të rifreskuar, brenda muajit të fundit, .

Menjëherë

9. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast të shqyrtohen dhe të paraqiten për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi, të cilat kanë të bashkëlidhur licencën e shoqërisë ndërtuese, e cila plotëson kërkesat e nenit 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

10. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast të shqyrtohen dhe të paraqiten për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi të cilat kanë të plotësuar formularët 1, 3 dhe 3/1 dhe që janë brenda afateve ligjore për shqyrtim .

Vazhdimisht

11. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast të shqyrtohen dhe të paraqiten për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi të cilat kanë të plotësuar dokumentacionin teknik dhe disponohet oponenca teknike në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998.

Vazhdimisht

12. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo dosje të sistemohet dhe të inventarizohet dokumentacioni përfundimtarë që ndodhet në dosjet përkatëse, në përputhje me nenin 24, gërma b, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe të nenit 4 dhe 5 kapitulli II mbi “Detyrat e sekretarit-arkivit të organit të organit shtetërorë” të “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”.

Vazhdimisht

13. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast dhe për çdo vendim të zbatohet procedura e protokollimit të dokumentacionit që zbardhin vendimet dhe kërkesat për leje sheshi dhe leje ndërtimi, duke qenë transparent me afatet dhe procedurat që kryhen.

Vazhdimisht

14. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të mos pranohet dhe të mos shqyrtohet kërkesa për leje shfrytëzimi, për vendimet e KRRT-së respektive, pa u plotësuar më parë me dokumentacionin e konstatuar që mungon në dosje. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të mos pranohet dhe të mos shqyrtohet kërkesa për leje shfrytëzimi për subjektet ndërtuese dhe investitorët, pa pasur më parë një vërtetim nga Zyra e Financës, që të vërtetojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve financiare.

Vazhdimisht

15. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të regjistrojnë të dhëna përkatëse, duke krijuar regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin që administrojnë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit .

Vazhdimisht

16. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të ushtrojë vazhdimisht kompetencat në lidhje me kontrollin e zhvillimit për zbatimin e instrumentave të planifikimit dhe të marrin masat përkatëse për të shmangur shkeljet mjedisore dhe abuzimet me territorin.

Vazhdimisht

17. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të rrisë bashkëpunimin me strukturat e tjera brenda komunës dhe me autoritet e tjera të planifikimit të çdo niveli duke shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

Vazhdimisht

18. Të merren masa nga Komuna Udenisht për të riparuar të gjitha dëmtimet e shtresave asfaltike aty ku ka rrëshqitje, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik “Ndërtim Asfaltim Rruga (N.A.RR)” sh.a. për ndërtimin e “Rikonstruksion i Rrugëve të brendshme në fshatin Udenisht” Pogradec, dhe për marrjen në dorëzim të riparimeve të ngrihet komisioni me specialistë të fushës.

Menjëherë

19. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, të plotësoj me dokumentacion të plotë tekniko-ligjor dosjet e zbatimit të investimeve dhe të inventarizojë dosjet teknike të zbatimit të kontratave të ndërtimit, në zbatim të neneve 4 e 5, 24, germa “b”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”.

Menjëherë

20. Të ndiqet me përparësi arkëtimi i detyrimeve të pa shlyera sipas programit të auditimit nr. 256/1, datë 05.06.2008 nga KLSH “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, zbatimin e procedurave për miratimin e studimeve urbanistike pjesore etj”.

Menjëherë

21. Të ndiqet me përparësi arkëtimi i detyrimeve të pa shlyera në vlerën prej **57,570 lekë** si përfitim i padrejtë nga punonjësit Dh.L. debitore për vlerën prej 10,460 lekë, B.Ll. debitore për vlerën prej 2,224 lekë, L.B. debitore për vlerën prej 25,362 lekë dhe N.E. debitore për vlerën prej 19,584 lekë.

Menjëherë

22. Komuna Udenisht në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2014 të marrë masa për rishikimin me grup pune të normativave karburantit sipas llojeve të automjeteve dhe pajisjeve, si dhe të mbajë dokumentacion të rregullt me qëllim pasqyrimin e saktë të konsumit të karburantit.

Vazhdimisht

23. Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për planifikimin real të taksave e tarifave vendore, bazuar në të dhënat që disponon komuna dhe realizimeve të mëparshme, duke i programuar ato hollësisht sipas llojit të biznesit dhe detyrimeve përkatëse.

Vazhdimisht

24. Zyra e Taksave Vendore të marrë masa për, hartimin e planit vjetor në ushtrimin e kontrolleve në drejtimit e përcaktuara, në zbatim të pikës 10 “Kontrolli tatimor”, udhëzimit të përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

Vazhdimisht

25. Zyra e Taksave Vendore të njoftojë të gjithë abonentët familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet që ata kanë për taksat dhe tarifave vendore, në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” i ndryshuar dhe të mbajë evidencë për ecurinë e përmbushjes së detyrimit në një regjistër të veçantë, me qëllim aplikimin e masave të tjera shtrënguese në rast mos përmbushje të tyre.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

26. Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të kërkojë në rrugë administrative e ligjore duke ndjekur me përgjegjësi çdo shkallë gjykimi për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

27. Zyra e Taksave Vendore të marrë masa organizative dhe ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e taksave që arkëtohen nga njësitë e tjera publike si ZVRPP Pogradec etj, duke kërkuar e bërë rakordime periodike dhe ushtrimin e të drejtës ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor me qëllim rritjen e të ardhurave.

Në vazhdimësi

28. Zyra e Taksave Vendore të nxjerrë njoftim për vlerësimet e debitorëve subjekte të biznesit të madh, të vogël dhe institucione shtetërore, për mos likuidimet në afat të detyrimeve për taksat e tarifatat e pa likuiduara në zbatim të nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Brenda muajit Maj 2014

29. Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës dhe Zyrën e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të bëjë verifikimin në terren të sipërfaqeve që posedojnë subjektet tregtare në raport me sipërfaqen e deklaruar dhe sipërfaqen për të cilën paguajnë, procedurë e cila duhet të ndiqet dhe për subjektet të cilët kanë marrë me qira sipërfaqe toke nga komuna.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

30. Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të evidentoj, vlerësojë dhe kërkojë arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifatat vendore vitin 2011-2013, si dhe të hartohen njoftim vlerësimet për subjektet e biznesit të vogël, në zbatim të nenit 70/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

Brenda muajit Maj 2014

30. Komuna Udenisht t’i kërkojë ALUIZNI^t Pogradec, që pas përfundimit të procesit të legalizimit të evidentojë parcelat e tokës të klasifikuara shtet, me qëllim përfshirjen e tyre në listën e inventarit të pronave të bashkisë në zbatim të VKM përkatëse.

Në vazhdimësi

31. Komuna Udenisht të marrë masa për tu kryer inventarizimin fizik të aseteve në pronësi në përputhje me VKM që ka bërë kalimin me inventarizim, me qëllim vënien në efikasitet të aseteve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të parashikojë fonde për të bërë regjistrimin e tyre, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Brenda muajit Qershor 2014

32. Komuna Udenisht të kryej inventarizimin fizik të aseteve në pronësi apo përdorim të komunës të cilat rezultojnë se janë dhënë me qira subjekteve fizikë apo juridike. Grupi i punës të evidentojë saktësisht për secilën kontratë qiraje sipërfaqen e marrë me qira në raport me atë të cilën realisht shfrytëzojnë subjektet qiramarrëse si dhe sipërfaqet e objekteve të ngritura me trojet e marra me qira.

Brenda muajit Mars 2014

33. Komuna Udenisht, Grupi i punës, pas saktësimit të diferencave ndërmjet sipërfaqeve të marra me qira me ato të cilat realisht shfrytëzohen nga subjektet, të përlllogarisë efektin financiar të secilës kontratë, duke i propozuar titullarit të komunës lidhjen e kontratave sipas gjendjes faktike.

Brenda muajit Mars 2014

34. Komuna Udenisht, Grupi i punës, pas saktësimit të sipërfaqeve ndërtimore të ngritura brenda trojeve të marra me qira, të përlllogarisë efektin financiar të secilës kontratë, duke i propozuar titullarit të komunës lidhjen e kontratave për objektin sipas gjendjes faktike, si dhe duke bërë përlllogaritjen e vlerës së qirasë për çdo metër katror objekt, si tokë truall, sipas VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

Brenda muajit Mars 2014

35. Komuna Udenisht, Kryetari i Komunës dhe Këshilli i Komunës, bazuar në konstatimet e bërë nga grupi i auditimit, të marrë në shqyrtim çdo kontratë qiraje, lidhur me periudhën e marrjes me qira për ato raste kur këshilli nuk është shprehur për kohëzgjatjen e qirasë, saktësimit të sipërfaqeve të tokës së lirë dhe asaj me ndërtim si dhe rishikimit të atyre kontratave për të cilat ka rezultuar se është dhënë për tokë pyjore e kullosore kur sipërfaqja rezulton fond toke bujqësore e pafrytshme.

Brenda muajit Mars 2014

36. Komuna Udenisht, Kryetari i Komunës dhe Këshilli i Komunës, bazuar në konstatimet e bërë nga grupi i auditimit, të marrë në shqyrtim çdo kontratë qiraje, lidhur me periudhën e marrjes me qira për ato

raste kur këshilli nuk është shprehur për kohëzgjatjen e qirasë, saktësimin të sipërfaqeve të tokës së lirë dhe asaj me ndërtim si dhe rishikimin të atyre kontratave për të cilat ka rezultuar se është dhënë për tokë pyjore e kullimore kur sipërfaqja rezulton fond toke bujqësore e pafrytshme.

Brenda muajit Mars 2014

37. Komuna Udenisht, Kryetari i Komunës dhe Këshilli i Komunës, bazuar në konstatimet e bërë nga grupi i auditimit, të marrë në shqyrtim çdo kontratë qiraje për të cilën ka rezultuar se qëllimi i përdorimit ka qenë ndërtimi i objekteve ndërtimore me karakter ekonomik, për të cilat janë miratuar dhe leje ndërtimore përkatëse, duke bërë përlllogaritjen e sipërfaqes nën objekt dhe asaj funksionale në bazë të VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

Brenda muajit Mars 2014

38. Komuna Udenisht, Kryetari i Komunës bazuar në konstatimet e bëra nga grupi i auditimit se disa subjekte nuk kanë paguar detyrimin financiar që lindin nga miratimi e zbatimi i kontratave të qirasë, por dhe për ato subjekte që nuk e kanë paguar në kohë këtë detyrim, të përlllogarisë dhe kërkojë vlerën e kamatëvonesave për çdo subjekt qiramarrës.

Brenda muajit Mars 2014

39. Komuna Udenisht, Kryetari i Komunës bazuar në konstatimet e bëra nga grupi i auditimit se disa subjekte nuk kanë paguar detyrimin financiar që lindin nga miratimi e zbatimi i kontratave të qirasë, të propozojë në Këshillin e Komunës, prishjen e kontratave të qirasë dhe eliminimin e çdo pasoje të krijuar nga zbatimi i deritanishëm i tyre, sipas përcaktimeve të bëra në secilën kontratë lidhur me të drejtat e qiradhënësit.

Brenda muajit Mars 2014

40. Komuna Udenisht, Kryetari i Komunës dhe Këshilli i Komunës bazuar në konstatimet e bëra nga grupi i auditimit se disa subjekte kanë lidhur kontratë qiraje të pa miratuar më parë në këshillin e komunës apo është kryer miratimi në parim por nuk janë zbardhur nga kryetari i këshillit, si dhe në disa raste sipërfaqja është e ndryshme nga ajo e miratuar, të vendosë për prishjen e kontratave të qirasë dhe eliminimin e çdo pasoje të krijuar nga zbatimi i deritanishëm i tyre, sipas përcaktimeve të bëra në secilën kontratë lidhur me të drejtat e qiradhënësit.

Brenda muajit Mars 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **2,294,152 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Nga Komuna Udenisht të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **1,452,509 lekë** pasi në prokurimin me objekt: **Asfaltim i Rrugëve të Brendshme Udenisht**, realizuar nga shoqëria “N...” sh.a., në përcaktimin e fondit limit nga AK, projekti i hartuar nga projektuesi si efekt i mos zbatimit të manualit ka devijuar nga VKM nr. 1027, datë 15.12.2010 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, duke sjellë rritje të çmimeve për rrjedhojë dhe përfitime të pamërituara për OE.

Menjëherë

2. Nga Komuna Udenisht të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **623,544 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik “N...” sh.a. të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Rrugëve të brendshme në fshatin Udenisht” Pogradec.

Menjëherë

- 3.1. Investitorit R.D., ka paguar më pak vlerën **52,900 lekë**, për lejen e përdorimit të objektit “Bar restorant Motel 4 kate”.
- 3.2. Investitorit A.D., ka paguar më pak vlerën **52,900 lekë**, për lejen e përdorimit të objektit “Bar restorant Motel 3 kate”.
- 3.3. Investitorit E.Ç., ka paguar më pak vlerën **50,000 lekë**, për lejen e përdorimit të objektit “Bar restorant-Hotel 3 kat”.
- 3.4. Investitorit B.A., ka paguar më pak vlerën **30,000 lekë**, për lejen e përdorimit të objektit “Motel 2 kat+parking”.
- 3.5. Investitori Gj.I., ka paguar më pak vlerën **23,200 lekë** për lejen e përdorimit të objektit “Kompleks Sportiv PANI”.
- 3.7. Investitori H.M., ka paguar më pak vlerën **18,800 lekë** për ndërtimin e objektit “Banesë vetjake 2 kat”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

I. Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës Udënisht, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim”, për:

1. K.S., me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Taksave, pasi:

-Ka lejuar mos realizimin e të ardhurave për vitet 2011 dhe 2012, **duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Komunës për vlerën gjithsej 4,632,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

-Për detyrimet debitoare të vitit 2011 dhe 2012 të cilat paraqiten në shumën **4,632,973 lekë, penalteti i paaplikuar nga ZTTV paraqitet në shumën 1,158,243 lekë**, duke mos u aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008.

-Për lejin e subjekteve të cilëve u janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore por që nuk janë regjistruar në QKR, në kundërshtim me nenin 40, pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

-Për mos mbajtjen e regjistrit themelor (progresiv) të tatim paguesve të subjekteve të biznesit të madh, vogël, institucioneve shtetërore dhe abonentëve familjarë, si dhe për mos hapjen e kartelave personale për të gjitha detyrimet mbi taksat e tarifave vendore, në referim të pikës 7, të nenit 3, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, dhe pika 9, e udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007.

-Për lejin e krijimit të subjekteve të cilët janë kaluar me status pasiv dhe që rezultojnë debitorë, dhe nga administrata e taksave vendore nuk është bërë evidentimi dhe arkëtimi i këtyre vlerave në momentin e krijimit të tyre ose në periudhat e mëvonshme, të ardhura këto të munguara në buxhetin e bashkisë, po ashtu rezulton se si për subjekte me humbje dhe atyre me status pasiv nuk është zbatuar i plotë neni 45, të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008.

-Për mos aplikimi sanksionesh për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të nenit 17 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, neni 114, ndërsa për penaltetet (gjohat) e aplikuar, nuk dokumentohet njoftimi i subjekteve me njoftim vlerësim, në referencë kjo të nenit 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, me qëllim kontabilizimin dhe arkëtimin e tyre.

-Mos aplikim të penaliteteve në momentin e aplikimit e krijimit të, por në kohën që subjekti paraqitet për kryerjen e veprimeve të ndryshme në komunë, veprime këto në kundërshtim me nenin 17, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe neni 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

-Për vjeljen e detyrimeve tatimore nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në zbatim ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, si; nuk u janë dërguar Bankave të nivelit të dytë subjektet, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008; nuk është kërkuar, që ndaj subjekteve debitorë, vendosja e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Transportit për mjetet, apo ZVRPP, kjo bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008; mos zbatim të procedurave të parashikuara në Kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 dhe pikat 3 dhe 5, të udhëzimit të MF dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003; pikat 4. nën-pikat 4.1.4.3, pikat 5, 6, 8 dhe 9 e udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06.02.2007; nenin 17 dhe neni 34, shkronja “a”, pika 3, pasi nuk është proceduar në mbylljen e subjekteve debitor të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat e tarifave vendore; si dhe nuk është bashkëpunuar me DRT për arkëtimin e detyrimeve debitorë të subjekteve të Biznesit të Madh.

Për mosdërgimin në zyrën e financës të komunës të debitorëve me qëllim kontabilizimin e detyrimeve të paarkëtuara, veprime kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, -Mbajtja e kontabilitetit, pika 2, germa (c), -Dokumentet e kontabilitetit, pika 2.3 -Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

-Mos inventarizimi i dosjeve.

-Mungesa e dokumentacionit mbi llogaritjen e taksës së pasurisë (ndërtesës) si të dhënat nga ZVRPP Korçë (genplane, certifikata e pronësisë).

-Në subjektet që kanë reklama, mungon dokumentacioni mbi të dhënat e sipërfaqes së tij të cilat janë bazën për llogaritjen e taksës së reklamës.

-Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, vendose nga zyra duke u bazuar në vetëdeklarimet e subjekteve (parashikimin) dhe mungesa e kontrolleve mbi të ardhurat e realizuara në periudha të ndryshme.

-Për mungesë dokumentacioni, si aktkontrolle mbi verifikimin e xhiros së subjekteve, të dhëna të marra nga institucionet e tjera (Dega e Thesarit Korçë, DRT Korçë, Dogana, etj), mbi të transaksionet e ndryshme që mund të jenë kryer nga subjektet fizike, në referencë të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, UMF nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe nenit 61, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2011-2013, në procedurën e prokurimit “Ndërtim Ambulance tip A-1” viti 2011, “Pastrimi dhe largimi i mbeturinave urbane” viti 2012, “Sistemi asfaltim rruga lart, fshati Memelisht” viti 2012 dhe “Ndërtim Kopshti Çervetakë” viti 2013, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. I.D., me detyrë inspektor,

3. A.A., me detyrë inspektor dhe

4. A.Sh., me detyrë inspektor, pasi:

-Kanë lejuar mos realizimin e të ardhurave për vitet 2011 dhe 2012, **duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Komunës për vlerën gjithsej 4,632,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

-Për detyrimet debitorë të vitit 2011 dhe 2012 të cilat paraqiten në shumën **4,632,973 lekë, penalti i paaplikuar nga ZTTV paraqitet në shumën 1,158,243 lekë**, duke mos u aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008.

-Për lejin e subjekteve të cilëve u janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore por që nuk janë regjistruar në QKR, në kundërshtim me nenin 40, pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

-Për mos aplikimi sanksionesh për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të nenit 17 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, neni 114, ndërsa për penalitetet (gjobat) e aplikuar, nuk dokumentohet njoftimi i subjekteve me njoftim vlerësim, në referencë kjo të nenit 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, me qëllim kontabilizimin dhe arkëtimin e tyre.

-Mos aplikim të penalteteve në momentin e aplikimit e krijimit të, por në kohën që subjekti paraqitet për kryerjen e veprimeve të ndryshme në komunë, veprime këto në kundërshtim me nenin 17, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe neni 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

-Mos inventarizimi i dosjeve.

-Mungesa e dokumentacionit mbi llogaritjen e taksës së pasurisë (ndërtesës) si të dhënat nga ZVRPP Korçë (genplane, certifikata e pronësisë).

-Në subjektet që kanë reklama, mungon dokumentacioni mbi të dhënat e sipërfaqes së tij të cilat janë bazën për llogaritjen e taksës së reklamës.

-Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, vendose nga zyra duke u bazuar në vetëdeklarimet e subjekteve (parashikimin) dhe mungesa e kontroleve mbi të ardhurat e realizuara në periudha të ndryshme.

-Për mungesë dokumentacioni, si aktkontrolle mbi verifikimin e xhiros së subjekteve, të dhëna të marra nga institucionet e tjera (Dega e Thesarit Korçë, DRT Korçë, Dogana, etj), mbi të transaksionet e ndryshme që mund të jenë kryer nga subjektet fizike, në referencë të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, UMF nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe nenit 61, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

5. B.B., me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Urbanistikës. pasi:

- Ka lejuar krijimin e një **dëmi ekonomik prej 103.200 lekë**, për 3 subjekte të cilat janë pajisur me leje përdorimi pa kryer më parë tarifën për lëshimin e këtij akti veprime në kundërshtim me përcaktimet e VKK nr. 101, datë 10.01.2013 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” dhe ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

- *Për 15 kontrata për vitin 2012 dhe 9 kontrata për vitin 201 të dhënies me qira të fondit pyjor e kullor dhe tokës bujqësore të Komunës Udenisht, për të cilat është konstatuar se:*

Në miratimin e lidhjen e kontratave të qirasë, nga ana e Komunës Udenisht nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimet pyjore”, ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, si dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, ndërsa për ato që kanë kaluar nga fondi i tokës bujqësore është VKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara”, ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, por dhe VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, akt i cili është i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqet të cilat rezultojnë se janë zënë me objekte ndërtimore apo kanë destinacion të ndryshëm nga ai i përcaktuar tarifa dyshme e qirasë për truallin e lirë, është 100 lekë/ m² në muaj.

- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të Njesisë të Prokurimit për vitin 2012-2013, “Sistemi asfaltim rruga lart, fshati Memelisht” viti 2012 dhe “Ndërtim Kopshti Çervenakë” viti 2013, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për procedurat e prokurimit me blerje të vogla ku është konstatuar se:

- Mungon procesverbali i shqyrtimit të ofertave të tregut (formati 3) si dhe mungon projektpreventivi mbi përcaktimin e fondit limit, si dhe nuk ka referenca për përcaktimin e çmimeve për çdo njësi të prokuruar.
- Në rastet e blerjeve të pjesëve të këmbimit për riparimin e automjeteve në përdorim nuk ka akt-konstatimi paraprak ku specialistët e fushës të përshkruajnë të dhënat identifikuese dhe ato teknike të mjetit, defektet e paraqitura për përcaktimin e nevojave të kryerjes së shpenzimeve .
- Nuk është mbajtur procesverbal nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla ku të jenë pasqyruar nga 3 oferta, pasi në asnjë rast nuk janë evidentuar oferta përveç asaj të përzgjedhur.
- Nuk është kryer apo dhe nëse është realizuar nuk është evidentuar testimi i tregut.
- Nuk ka korrespondencë apo nuk rezulton e dokumentuar ti jetë kërkuar INSTAT-it lidhur me çmimet për çdo zë të prokuruar.
- Nuk janë përmbajtur apo nuk dokumentohet që tu jenë referuar manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.
- Nuk ka specifikime teknike të produkteve, për rrjedhojë nuk ka miratim nga titullari i autoritetit kontraktor si përgjegjës për menaxhimin e fondit të institucionit.
- Nuk ka librezë masash për rakordimin e punimeve të zërave sipas preventivit të prokurimit.
- Nuk ka aktkontrolle të ushtruara mbi realizimin në terren të punimeve të kryera.
- Nuk ka certifikatë cilësie për materialet e përdorura në punimet e kryera për ndërtim.
- Nuk ka kontratë për mbikëqyrjen e punimeve dhe kolaudimin mbi dorëzimin e punimeve për objektet e ndërtimit.
- Janë kryer disa procedura me vlera të vogla për disa artikuj e grup artikujsh në tejkalim të kufirit monetar prej 400,000 lekë.

Në kundërshtim me nenin 1, 4, 12, 23 dhe 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” Kreu II pika 1 germa “b”, “Kufijtë monetarë”, germa “b”, ku thuhet “Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 400 mijë lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlera të vogla”, si dhe pika “d” dhe “c”; kreu VI pika 2 e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe pikat 1, 3 dhe 4 të Udhëzimi i APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, si dhe në kundërshtim me nenin paragrafi 3, neni 7 i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

6. Dh.L., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financë-Buxhetit, pasi:

Për 15 kontrata për vitin 2012 dhe 9 kontrata për vitin 201 të dhënies me qira të fondit pyjor e kullësor dhe tokës bujqësore të Komunës Udenisht, për të cilat është konstatuar se:

Në miratimin e lidhjen e kontratave të qirasë, nga ana e Komunës Udenisht nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimet pyjore”, ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, si dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, ndërsa për ato që kanë kaluar nga fondi i tokës bujqësore është UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara”, ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, por dhe VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, akt i cili është i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqet të cilat rezultojnë se janë zënë me objekte ndërtimore apo kanë destinacion të ndryshëm nga ai i përcaktuar tarifa dysHEME e qirasë për truallin e lirë, është 100 lekë/ m² në muaj.

- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2013, në procedurën e prokurimit “Ndërtim Kopshti Çervenakë”,

veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për procedurat e prokurimit me blerje të vogla ku është konstatuar se:

- Mungon procesverbali i shqyrtimit të ofertave të tregut (formati 3) si dhe mungon projektpreventivi mbi përcaktimin e fondit limit, si dhe nuk ka referenca për përcaktimin e çmimeve për çdo njësi të prokuruar.
- Në rastet e blerjeve të pjesëve të këmbimit për riparimin e automjeteve në përdorim nuk ka akt-konstatimi paraprak ku specialistët e fushës të përshkruajnë të dhënat identifikuese dhe ato teknike të mjetit, defektet e paraqitura për përcaktimin e nevojave të kryerjes së shpenzimeve .
- Nuk është mbajtur procesverbal nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla ku të jenë pasqyruar nga 3 oferta, pasi në asnjë rast nuk janë evidentuar oferta përveç asaj të përzgjedhur.
- Nuk është kryer apo dhe nëse është realizuar nuk është evidentuar testimi i tregut.
- Nuk ka korrespondencë apo nuk rezulton e dokumentuar ti jetë kërkuar INSTAT-it lidhur me çmimet për çdo zë të prokuruar.
- Nuk janë përmbajtur apo nuk dokumentohet që tu jenë referuar manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.
- Nuk ka specifikime teknike të produkteve, për rrjedhojë nuk ka miratim nga titullari i autoritetit kontraktor si përgjegjës për menaxhimin e fondit të institucionit.
- Nuk ka librezë masash për rakordimin e punimeve të zërave sipas preventivit të prokurimit.
- Nuk ka aktkontrolle të ushtruara mbi realizimin në terren të punimeve të kryera.
- Nuk ka certifikatë cilësie për materialet e përdorura në punimet e kryera për ndërtim.
- Nuk ka kontratë për mbikëqyrjen e punimeve dhe kolaudimin mbi dorëzimin e punimeve për objektet e ndërtimit.
- Janë kryer disa procedura me vlera të vogla për disa artikuj e grup artikujsh në tejkalim të kufirit monetar prej 400,000 lekë.

Në kundërshtim me nenin 1, 4, 12, 23 dhe 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” Kreu II pika 1 germa “b”, “Kufijtë monetarë”, germa “b”, ku thuhet “Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 400 mijë lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlera të vogla”, si dhe pika “d” dhe “c”; kreu VI pika 2 e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe pikat 1, 3 dhe 4 të Udhëzimit i APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, si dhe në kundërshtim me nenin paragrafi 3, neni 7 i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

7. F.A., me detyrë NënKryetar i Komunës, pasi:

- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2011-2013, në procedurën e prokurimit “Ndërtim Ambulance tip A-1” viti 2011, “Pastrimi dhe largimi i mbeturinave urbane” viti 2012, “Sistemim asfaltim rruga lart, fshati Memelisht” viti 2012 dhe “Ndërtim Kopshti Çervenakë” viti 2013, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për procedurat e prokurimit me blerje të vogla ku është konstatuar se:

- Mungon procesverbali i shqyrtimit të ofertave të tregut (formati 3) si dhe mungon projektpreventivi mbi përcaktimin e fondit limit, si dhe nuk ka referenca për përcaktimin e çmimeve për çdo njësi të prokuruar.

- Në rastet e blerjeve të pjesëve të këmbimit për riparimin e automjeteve në përdorim nuk ka akt-konstatimi paraprak ku specialistët e fushës të përshkruajnë të dhënat identifikuese dhe ato teknike të mjetit, defektet e paraqitura për përcaktimin e nevojave të kryerjes së shpenzimeve .
- Nuk është mbajtur procesverbal nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla ku të jenë pasqyruar nga 3 oferta, pasi në asnjë rast nuk janë evidentuar oferta përveç asaj të për zgjedhur.
- Nuk është kryer apo dhe nëse është realizuar nuk është evidentuar testimi i tregut.
- Nuk ka korrespondencë apo nuk rezulton e dokumentuar ti jetë kërkuar INSTAT-it lidhur me çmimet për çdo zë të prokuruar.
- Nuk janë përmbajtur apo nuk dokumentohet që tu jenë referuar manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.
- Nuk ka specifikime teknike të produkteve, për rrjedhojë nuk ka miratim nga titullari i autoritetit kontraktor si përgjegjës për menaxhimin e fondit të institucionit.
- Nuk ka librezë masash për rakordimin e punimeve të zërave sipas preventivit të prokurimit.
- Nuk ka aktkontrolle të ushtruara mbi realizimin në terren të punimeve të kryera.
- Nuk ka certifikatë cilësie për materialet e përdorura në punimet e kryera për ndërtim.
- Janë kryer disa procedura me vlera të vogla për disa artikuj e grup artikujsh në tejkalim të kufirit monetar prej 400,000 lekë.

Në kundërshtim me nenin 1, 4, 12, 23 dhe 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” Kreu II pika 1 germa “b”, “Kufijtë monetarë”, germa “b”, ku thuhet “Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 400 mijë lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlera të vogla”, si dhe pika “d” dhe “c”; kreu VI pika 2 e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe pikat 1, 3 dhe 4 të Udhëzimit i APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, si dhe në kundërshtim me nenin paragrafi 3, neni 7 i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

8. L.J., me detyrë Juriste e Komunës, pasi:

Për 15 kontrata për vitin 2012 dhe 9 kontrata për vitin 2013 të dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor dhe tokës bujqësore të Komunës Udenisht, për të cilat është konstatuar se:

Në miratimin e lidhjen e kontratave të qirasë, nga ana e Komunës Udenisht nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimet pyjore”, ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, si dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, ndërsa për ato që kanë kaluar nga fondi i tokës bujqësore është UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara”, ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, por dhe VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, akt i cili është i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqet të cilat rezultojnë se janë zënë me objekte ndërtimore apo kanë destinacion të ndryshëm nga ai i përcaktuar tarifa dysheme e qirasë për truallin e lirë, është 100 lekë/ m² në muaj.

- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të Anëtarit të Njesisë së Prokurimit për vitin 2012-2013, në procedurën e prokurimit “Sistemim asfaltim rruga lart, fshati Memelisht” viti 2012 dhe “Ndërtim Kopshti Çervenakë” viti 2013, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

9. V.B., me detyrë aktuale specialiste e urbanistikës, pasi:

- Në cilësinë e Sekretares së KRRT dhe Përgjegjëse e Zyrës së urbanistikës ka lejuar krijimin e një **dëmi ekonomik prej 123.900 lekë**, për 3 subjekte të cilat janë pajisur me leje përdorimi pa kryer më parë tarifën për lëshimin e këtij akti.
- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të Sekretares së KRRT dhe Përgjegjëses së Zyrës së Urbanistikës, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar si dhe VKM Nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.
- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të Njesisë të Prokurimit për vitin 2011-2012, në procedurën e prokurimit “Ndërtim Ambulance tip A-1” viti 2011, “Pastrimi dhe largimi i mbeturinave urbane” viti 2012, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për procedurat e prokurimit me blerje të vogla ku është konstatuar se:

- Mungon procesverbali i shqyrtimit të ofertave të tregut (formati 3) si dhe mungon projektpreventivi mbi përcaktimin e fondit limit, si dhe nuk ka referenca për përcaktimin e çmimeve për çdo njësi të prokuruar.
- Nuk është mbajtur procesverbal nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla ku të jenë pasqyruar nga 3 oferta, pasi në asnjë rast nuk janë evidentuar oferta përveç asaj të përzgjedhur.
- Nuk është kryer apo dhe nëse është realizuar nuk është evidentuar testimi i tregut.
- Nuk ka korrespondencë apo nuk rezulton e dokumentuar ti jetë kërkuar INSTAT-it lidhur me çmimet për çdo zë të prokuruar.
- Nuk janë përmbajtur apo nuk dokumentohet që tu jenë referuar manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.
- Nuk ka specifikime teknike të produkteve, për rrjedhojë nuk ka miratim nga titullari i autoritetit kontraktor si përgjegjës për menaxhimin e fondit të institucionit.
- Nuk ka librezë masash për rakordimin e punimeve të zërave sipas preventivit të prokurimit.
- Nuk ka aktkontrolle të ushtruara mbi realizimin në terren të punimeve të kryera.
- Nuk ka certifikatë cilësie për materialet e përdorura në punimet e kryera për ndërtim.

Në kundërshtim me nenin 1, 4, 12, 23 dhe 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” Kreu II pika 1 germa “b”, “Kufijtë monetarë”, germa “b”, ku thuhet “Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 400 mijë lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlera të vogla”, si dhe pika “d” dhe “c”; kreu VI pika 2 e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe pikat 1, 3 dhe 4 të Udhëzimi i APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, si dhe në kundërshtim me nenin paragrafi 3, neni 7 i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

10. B.Ll., me detyrë Specialiste e Ndhmës Ekonomike, pasi:

- Për shkelje e parregullsi të konstatuara gjatë ushtrimit të funksionit të Anëtarit të Njesisë së Prokurimit për vitin 2012-2013, në procedurën e prokurimit “Sistemim asfaltim rruga lart, fshati Memelisht” viti 2012 dhe “Ndërtim Kopshti Çervenakë” viti 2013, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE.

Nga Komuna Udënisht të merren masa në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, në mungesë të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor Komunal, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Pogradec, **të vendosë gjobë** për mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit **B.B.**, Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt “*Rikonstruksion i Rrugëve të brendshme në fshatin Udënisht*”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik buxhetit të Komunës Udënisht në vlerën 623,544 lekë, shumë e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer, në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

F. KALLZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 225/12, datë 18.04.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec:

N.D. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Udënisht Pogradec

A.Sh. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës Urbanistikës

H.H. me detyrë ish-Kryetar i Këshillit të Komunës Udënisht Pogradec

Nga Komuna Udënisht, Pogradec me shkresë nr. 1161, prot, datë 13.10.2014, protokolluar në KLSH me nr.225/14 datë 17.10.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Skënder Muca, Luan Kuka dhe Ryisim Xhaja më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT